

**Debati kombëtar për  
qëndrimet shtetërore në  
marrëdhëniet ndërkombëtare:  
Perspektivat e qytetarëve  
për integrimin euroatlantik  
të Maqedonisë së Veriut**



Instituti  
për  
politikë  
evroplane.  
Shkup



NATIONAL  
DEMOCRATIC  
DEBATE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



Përmbledhje e politikave

Debati kombëtar për  
qëndrimet shtetërore në  
marrëdhëniet ndërkombëtare:  
Perspektivat e qytetarëve  
për integrimin euroatlantik të  
Maqedonisë së Veriut

Botues:

Instituti për politikë evropiane – Shkup

Dizajn grafik:

Relativ

Tetor, 2024

Ky dokument bazohet në rezultatet e Anketës së katërt debatuese të mbajtur në Korrik 2024 organizuar në kuadër të projektit “Nxitje e analizës së politikave dhe debatit publik 3.0”, të cilin e realizon Instituti për politikë evropiane (EPI) - Shkup në bashkëpunim me Universitetin Stanford në ShBA, ndërsa financohet nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet dhe qëndrimet e Institutit për Politikë Evropiane dhe Fondacionit Kombëtar për Demokraci (NED) të ShBA-së.



## Përmbledhja


1. Hyrje.....4
2. Vështrime kyçe nga debata nacionale anketuese.....6
  - 2.1. Kuptimi i politikës së jashtme.....7
  - 2.2. Pikëpamje mbi integrimin në BE dhe përafrimin me PPJS.....9
  - 2.3. Pikëpamje për anëtarësimin në NATO dhe sigurinë kombëtare..... 11
3. Konkluzione dhe rekomandime..... 12



## 1. Hyrje

Politika e jashtme e një vendi është kyçe në përpjekjet e saj për të siguruar vendin brenda komunitetit ndërkombëtar. Që nga pavarësia, Maqedonia e Veriut është fokusuar në integrimin në strukturat euro-atlantike si Bashkimi Evropian (BE) dhe Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Arritja e anëtarësimit në NATO në mars 2020 ishte një moment i rëndësishëm historik,<sup>1</sup> që forcon sigurinë dhe shtrirjen strategjike të vendit, ndërsa anëtarësimi në BE mbetet një objektivi i vazhdueshëm.<sup>2</sup>

Në situatën aktuale ndërkombëtare, kuptimi i perceptimeve publike për këto rreshtime të politikës së jashtme është më i rëndësishëm se kurrë. Ndërsa Maqedonia e Veriut vazhdon të lundrojë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE dhe përmbush angazhimet e saj si anëtare e NATO-s, është e rëndësishme të sigurohet që këto përpjekje të reflektojnë dhe adresojnë shqetësimet dhe pikëpamjet e qytetarëve të saj. Vështrimi i opinionit publik ndihmon në zhvillimin e politikave që mbështesin në mënyrë efektive objektivat ndërkombëtare të vendit duke ruajtur mbështetjen e gjerë të brendshme. Politikat që reflektojnë dhe përgjigjen ndaj pikëpamjeve të qytetarëve janë vendimtare për nxitjen e legjitimitetit.



### NGJARJA DELIBERATIVE

6-7 July 2024

135 pjesëmarrës

### ANKETA PAS DEBATIT

N = 135 pjesëmarrës  
82.2% Maqedonas  
14.6% Shqiptarë  
3.2% bashkësitë tjera etnike



Për të vlerësuar dhe kuptuar në mënyrë efektive perspektivat e publikut, Instituti për politikë evropiane (EPI) kreu një anketë debatuase, një formë e veçantë e konsultimit politik e udhëhequr nga Deliberative Democracy Lab (i njohur më parë si Qendra për Demokraci Deliberative) pranë Universitetin Stanford. Kjo metodë kombinon anketën tradicionale të opinionit publik me diskutimin e informuar publik, dhe synon të zbulojë se si opinionit publik mund të ndryshojë kur qytetarët kanë mundësinë të angazhohen tërësisht me një temë. Pjesëmarrësit anketohen për çështje specifike si përpara ashtu edhe pasi të angazhohen në diskutime të hollësishme mes tyre dhe me ekspertë dhe figura politike, duke dhënë hapësirë për një analizë se si opinionet mund të ndryshojnë derisa pjesëmarrësit informohen dhe përfshihen më tepër.<sup>3</sup>

1 'Anëtarësimi në Nato', Ministria për Punë të Jashtme (Министерство за надворешни работи и надворешна трговија) n.d., <https://www.mfa.gov.mk/mk/page/7/nato-chlenstvo>.

2 'Anëtarësimi në BE (Членство во EY)', Ministria për Punë të Jashtme (Министерство за надворешни работи и надворешна трговија), n.d., <https://www.mfa.gov.mk/mk/page/6/eu-chlenstvo>.

3 'Çka është Anketa Debatuese? (What Is Deliberative Polling®)?', Stanford Deliberative Democracy Lab, n.d., <https://deliberation.stanford.edu/what-deliberative-polling>.

Procesi diskutues filloi me një anketë fillestare, e kryer midis 27 maj dhe 14 qershor 2024, duke përfshirë një mostër përfaqësuese në nivel kombëtar prej 1001 të anketuar të rritur, nga e gjithë Maqedonia e Veriut. Kjo anketë fillestare përfshinte pyetje për njohuri dhe opinion/qëndrim, duke kapur një gamë të gjerë pikëpamjesh nga të anketuarit që përbëheshin nga 67% maqedonas, 24,6% shqiptarë dhe 8,4% nga grupet e tjera etnike.

Para ngjarjes, pjesëmarrësve iu dhanë materiale të balancuara informuese të shqyrtuara nga ekspertë përkatës për të siguruar që informacioni ishte i paanshëm dhe objektiv. Këto materiale shërbyen si bazë për diskutimet gjatë aktivitetit. Më 6 dhe 7 korrik 2024, u realizua një debat dyditor, gjatë së cilit 135 të anketuar morën pjesë në diskutime të thelluara për politikën e jashtme të Maqedonisë së Veriut, veçanërisht përafrimin e saj me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) të BE-së dhe anëtarësimin e saj në NATO. Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit kishin kontakt me ekspertë dhe figura politike për të zhvilluar një kuptim më thelbësor të çështjeve në fjalë. Pas ngjarjes, pjesëmarrësve iu dha sërish anketa fillestare, për të matur ndryshimet në perceptimet e tyre për temat e diskutuara, ku të anketuarit përbëheshin nga 82,2% maqedonas, 14,6% shqiptarë dhe 3,2% nga grupet e tjera etnike.

Kjo përmbledhje e politikave përmbledh gjetjet nga anketa debatuese, duke ofruar një pamje gjithëpërfshirëse se si evoluon opinioni publik kur qytetarët përfshihen në diskutime të informuara mbi tema komplekse të politikës së jashtme. Bazuar në këto njohuri, përmbledhja ofron rekomandime të zbatueshme që synojnë të harmonizojnë strategjitë ndërkombëtare të Maqedonisë së Veriut me pikëpamjet publike dhe të nxisin njohuritë rreth tyre tek qytetarët.

## 2. Vështrime kyçe nga debata nacionale anketuese


Gjatë viteve, politika e jashtme e Maqedonisë së Veriut është përcaktuar kryesisht nga ndjekja e anëtarësimit në BE dhe NATO. Ky fokus i dyfishtë pasqyron një orientim më të gjerë strategjik drejt Perëndimit, që synon të përforcojë institucionet demokratike të vendit, të rrisë ekonominë dhe sigurimin e një të ardhmeje të qëndrueshme brenda një konteksti kompleks rajonal. Megjithatë, rruga drejt integritit të plotë nuk kërkon vetëm mbështetje të gjerë publike, por edhe një kuptim të plotë të detyrimeve dhe sfidave që vijnë me të. Kjo përfshin njohjen e qytetarëve me politikën më komplekse si Politika e Përbashkët për Punë të Jashtme dhe Siguri (PPJS-ja) e BE-së, dhe pse harmonizimi i politikës së jashtme të Maqedonisë së Veriut me atë të BE-së është i nevojshëm për procesin e integritit.

Duke përdorur metodën e anketës debatuese, qëllimi ishte të vëzhgohej nëse ekspozimi ndaj informacionit gjithëpërfshirës dhe të paanshëm do të shkaktonte ndryshime në opinionin publik. Megjithatë, analiza tregon se në disa fusha, opinionet e pjesëmarrësve mbetën kryesisht të pandryshueshme.

Para debatit, 68% e pjesëmarrësve shprehën një interes të fortë për politikën e jashtme dhe sigurinë kombëtare, një nivel angazhimi që mbeti i qëndrueshëm (pikat mesatare prej 7.92 para dhe 8.00 pas debatit). Kjo sugjeron se interesi i pjesëmarrësve për këto çështje ishte i madh dhe nuk u ndryshua ndjeshëm nga debati.

Për sa i përket Bashkimit Evropian, shumica e pjesëmarrësve fillimisht kishin një opinion pozitiv (68.8%). Ndërsa pati një rënie të lehtë të ndjenjës pozitive dhe mbështetjes për integritin e Maqedonisë së Veriut në BE pas debatit, këto ndryshime nuk ishin statistikisht domethënëse (vlerat mesatare prej 7,73 para debatit dhe 7,19 pas debatit). Për më tepër, njohja e pjesëmarrësve me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së nuk çoi në asnjë përmirësim të saj, që pasqyron vështirësi në rritjen e të kuptuarit publik mbi çështjet komplekse të politikave, edhe përmes diskutimit të informuar.

**Sipas jush, cilat janë përfitimet kryesore të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO?**



Mbështetja për anëtarësimin në NATO mbeti e qëndrueshme në 71.8% para debatit, dhe nuk pësoi ndonjë ndryshim domethënës pas debatit. Rritja ekonomike vazhdoi të theksohet si përfitimi kryesor i anëtarësimit në BE dhe NATO, një pikëpamje e përforcuar si pasojë e debatit.

Derisa debati siguroi njohuri të vlefshme dhe inkurajoi diskutim, nuk ndryshoi ndjeshëm pikëpamjet themelore të pjesëmarrësve mbi politikën e jashtme, integrimin në BE dhe anëtarësimin në NATO. Ky rezultat pasqyron faktin se tema të tilla si integrimi në BE dhe anëtarësimi në NATO janë shpesh në diskursin publik, duke i bërë qytetarët të kenë mendim të mirëfilltë. Në të kundërt, çështjet më komplekse, si PPJS-ja e BE-së, janë më pak të spikatura dhe më pak të shpjeguara për publikun. Vetëm një ngjarje diskutimi nuk është e mjaftueshme për të përmirësuar ndjeshëm njohjen me tema të tilla komplekse, veçanërisht kur ato janë të diskutueshme dhe influencohen nga politizimi. Kjo sfidë nuk është unike për kontekstin tonë; vërehet edhe brenda vetë BE-së, ku progresi në integrimin më të thellë të politikës së jashtme ka qenë i kufizuar për shkak të asaj që ekspertët e përshkruajnë si një “kurth politizimi”.<sup>4</sup> I njëjti studim sugjeron gjithashtu se opinioni publik për PPJS brenda BE-së ndikohet më shumë nga argumentet thelbësore sesa nga përkatësitë ideologjike.<sup>5</sup> Kjo ilustron se natyra e debatit – veçanërisht, aftësia për të përcjellë elemente thelbësore – është vendimtare në formësimin e qëndrimeve publike dhe shmangien nga politizimi i politikave të tilla komplekse. Prandaj, për të arritur një ndikim më të thellë dhe më të qëndrueshme, duhet të ndërmerren iniciativa arsimore më të shpeshta dhe gjithëpërfshirëse që sigurojnë që diskutimet publike të jenë thelbësore dhe informative.

4 Davide Angelucci et al., ‘Opinionin publik dhe Politika Evropiane e Jashtme dhe e Sigurisë: A Egziston Risku i Politizimit? (Public Opinion and the European Foreign and Security Policy: Is There a Risk of Politicisation?)’, JOINT Research Papers, nr. 25 (Prill 2024), [https://www.jointproject.eu/wp-content/uploads/2024/04/joint\\_rp\\_25.pdf](https://www.jointproject.eu/wp-content/uploads/2024/04/joint_rp_25.pdf).

5 Angelucci et al.

## 2.1 Kuptimi i politikës së jashtme


Politika e jashtme shpesh shihet si “politikë e lartë”, një fushë e rezervuar tradicionalisht për elitat politike dhe ekspertët për shkak të natyrës së saj komplekse dhe implikimeve të gjera.<sup>6</sup>

Ndërlikimet e negociatave diplomatike, traktateve ndërkombëtare dhe aleancat strategjike janë zakonisht përtej përvojave të përditshme dhe shqetësimet e qytetarëve të zakonshëm, që vështrëson ata të kuptojnë plotësisht ose të ndihen të lidhur me këto çështje. Kjo shkëputje mund të rezultojë në mungesë të angazhimit publik ose të interesit për politikën e jashtme, duke përforcuar pikëpamjen se ajo nuk është drejtpërdrejt e rëndësishme për jetën e tyre të përditshme.

Fillimisht, pak më shumë se gjysma e të anketuarve (51.1%) besonin se politika e jashtme e Maqedonisë së Veriut ndikoi në jetën e tyre të përditshme, ndërsa pothuajse e njëjta përqindje (47.6%) mendonin se jo. Megjithatë, pas debatit, pati një ndryshim të dukshëm në perceptim. Vlerat mesatare u rritën nga 5.78 para debatit në 7.04 pas, duke treguar se debati rriti ndjeshëm ndërgjegjësimin për ndikimin e politikës së jashtme në jetën e përditshme. Kjo sugjeron që ndërsa qytetarët mund të mos i njohin gjithmonë efektet e menjëhershme të politikës së jashtme, diskutimet e informuara mund të përmirësojnë kuptimin e tyre për rëndësinë e saj gjatë përvojave të tyre të përditshme.

6 Christian Opitz, Hanna Pfeifer, dhe Anna Geis, ‘Angazhimi me Opinionin Publik në Nivel Mikro: Dialogu Qytetar dhe Pjesëmarrja në Politikën e Jashtme Gjermane (Engaging with Public Opinion at the Micro-Level: Citizen Dialogue and Participation in German Foreign Policy)’, Foreign Policy Analysis 18, nr. 1 (2022), <https://academic.oup.com/fpa/article/18/1/orab033/6414434>.


Në shkallë prej 0 deri në 10, ku 0 do të thotë nuk ka aspak ndikim, 10 do të thotë ka shumë ndikim, a ndikon politika e jashtme e Maqedonisë së Veriut në jetën tuaj të përditshme?



Para ngjarjes, një shumicë e madhe e të anketuarve (74%) besonin se stabiliteti rajonal dhe bashkëpunimi me vendet fqinje është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të ardhmen e Maqedonisë së Veriut, me 12% të tjerë që e konsiderojnë atë të rëndësishëm. Vetëm një përqindje e vogël (13.5%) i shikonte këto aspekte si më pak të rëndësishme. Pas ngjarjes, pikëpamjet e pjesëmarrësve mbi këtë temë mbetën të qëndrueshme, pa asnjë ndryshim statistikash domethënës. Vlerat mesatare ishin 8.87 para debatit dhe 8.59 pas debatit, duke treguar se pjesëmarrësit tashmë kishin pikëpamje të forta dhe të qëndrueshme për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal.

Përveç kësaj, të anketuarve iu kërkua të vlerësojnë rëndësinë e qëllimeve të ndryshme strategjike për Maqedoninë e Veriut. Para debatit kishte mbështetje të fortë për bashkëpunim në organizatat ndërkombëtare (84.8%), përkushtim për një rajon të qëndrueshëm dhe prosperues (83.3%) dhe promovim të interesave të vendit në skenën ndërkombëtare (81%). Respektivisht, anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe NATO është vlerësuar gjithashtu i rëndësishëm nga 75.9% dhe 74.3% e të anketuarve. Pas debatit, opinionet e pjesëmarrësve mbi këto objektiva mbetën kryesisht të pandryshuara, me vetëm një rënie të lehtë dhe jo domethënëse në mbështetjen për anëtarësimin në BE.

Çka paraqet politika e jashtme e një vendi?



Këto konstatime shfaqin që qytetarët e Maqedonisë së Veriut kanë një kuptim të forte e themelor të politikës së jashtme të vendit të tyre, veçanërisht në fusha si stabiliteti rajonal, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përafrimi strategjik me BE-në dhe NATO-n. Pikëpamjet e tyre për këto tema janë të rrënjosura thellë, siç dëshmohet nga ndryshimet minimale të opinionit para dhe pas debatit. Megjithatë, rritja e dukshme e ndërgjegjësimit se si politika e jashtme ndikon jetën e përditshme shfaq që derisa qytetarët kanë kuptim të thellë mbi qëllimet e gjera strategjike, ka akoma hapësirë për të thelluar kuptimin e tyre për implikimet e drejtpërdrejta të vendimeve të politikës së jashtme. Angazhimi i qytetarëve në diskutime që lidhin politikën e jashtme me rezultate të ndjeshme mund të forcojë më tej zotërimin e tyre mbi këto çështje komplekse, duke i bërë ata pjesëmarrës më të informuar në proceset demokratike.



## 2.2 Pikëpamje mbi integrimin në BE dhe përafrimin me PPJS

Me status si kandidat për anëtarësim që nga viti 2005, Maqedonia e Veriut ka qenë në një rrugë të vendosur drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian, me përpjekje të fokusuara në përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në procesin e anëtarësimin. Një nga kërkesat e procesit të anëtarësimin në BE është përafrimi me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (PPJS).<sup>7</sup> Ky rreshtim është vendimtar për Maqedoninë e Veriut pasi demonstroi përkushtimin e saj ndaj vlerave të BE-së dhe gatishmërinë e saj për të kontribuar në stabilitetin rajonal dhe global.

Para debatit, shumica e të anketuarve, 65% (43.9% plotësisht të vetëdijshëm, 21.1% deri diku të vetëdijshëm), treguan se kishin njohuri rreth hapave që duhet të ndërmerren Maqedonia e Veriut për të arritur anëtarësim të plotë në BE. Megjithatë, 34.4% e të anketuarve (20.6% pa njohuri, 13.8% aspak njohuri) nuk ishin të njohur me këto hapa. Pas debatit, nuk pati ndonjë ndryshim statistikash domethënës në nivelin e ndërgjegjësimit, që tregon një kuptim të qëndrueshëm, por të kufizuar në mesin e publikut.


Shumica e pjesëmarrësve (66.2%) besonin se bashkëpunimi brenda politikave të BE-së kontribuon në sigurinë rajonale dhe globale, duke reduktuar rrezikun e konflikteve. Megjithatë, një pjesë e tyre (29.1%) ishin të rezervuar për këtë nocion, që tregon për një ndarje të opinionit publik. Për më tepër, një segment i dukshëm i popullsisë (65.7%) mendon që përafrimi me politikën e jashtme të BE-së shpesh kërkon prioritizimin e interesave të BE-së mbi

ato kombëtare, duke reflektuar shqetësimet për kompromise të mundshme ndaj sovranitetit kombëtar. Po ashtu kishte shqetësime se përafrimi me politikën e jashtme të BE-së mund të çonte në tensione me vendet që nuk ndajnë interesat e BE-së (61.9%). Pavarësisht këtyre shqetësimeve, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve i njohën përfitimet e pjesëmarrjes në misionet e përbashkëta të BE-së, duke e parë atë si një mënyrë për të rritur aftësinë e Maqedonisë së Veriut për t'iu përgjigjur kërcënimeve globale dhe për të përmirësuar statusin dhe ndikimin e saj ndërkombëtar (64.4%). Debatu nuk çoi në ndryshime të jashtëzakonshme në qëndrimet ndaj PPJS-së së BE-së, duke treguar se pikëpamjet e pjesëmarrësve ose ishin veç më të vendosura ose se debatit i mungonte ndikimi për t'iu ndryshuar ato.

Kur u pyetën për momente të veçanta në procesin e integrimit të Maqedonisë së Veriut në BE, si kur vendit iu dha statusi i kandidatiit dhe kur filloi procesi i shqyrtimit për anëtarësimin në BE, një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish i identifikuan saktë këto ngjarje. Debatu pati një efekt pozitiv në përforcimin e njohurive për këto momente historike, me një rritje të lehtë të përgjigjeve të sakta më pas.

### Në cilin vit ka filluar procesi i skringing-ut për anëtarësimin në Bashkimin Evropian?

Një rritje e dukshme është vërejtur në përqindjen e pjesëmarrësve të cilët e identifikojnë vitin 2022 si përgjigje të saktë nga 17,2% para debatit në 26,7% pas debatit, gjë që tregon se ka më shumë qartësi pas debatit, si dhe nevojën për informim në kohë të qytetarëve për proceset kyçe në shtet.



<sup>7</sup> 'Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) / Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) në Ballkanin Perëndimor (Common Foreign and Security Policy (CFSP) / Common Security and Defence Policy (CSDP) in the Western Balkans, Aksioni i jashtëm i Bashkimit Evropian (European Union External Action), 16 Mars 2022, [https://www.eeas.europa.eu/eeas/common-foreign-and-security-policy-cfsp-common-security-and-defence-policy-csdp-western-balkans\\_en](https://www.eeas.europa.eu/eeas/common-foreign-and-security-policy-cfsp-common-security-and-defence-policy-csdp-western-balkans_en).

Diskutimi gjithashtu mbuloi edhe reagimin e BE-së ndaj agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, ku një shumicë e madhe e të anketuarve identifikuan saktë sanksionet ekonomike si reagim kryesor i BE-së. Sa i përket ndikimit të sanksioneve në Maqedoninë e Veriut, më shumë se gjysma e qytetarëve fillimisht besonin se sanksionet kundër Rusisë kishin çuar në rritjen e çmimeve të energjisë elektrike dhe pasoja të tjera ekonomike brenda vendit. Megjithatë, pas debatit, pati një rënie të ndjeshme në këtë besim, që shkaktoi disa pjesëmarrës ose të jenë të pasigurtë ose të ndryshojnë pikëpamjet e tyre. Ky ndryshim tregon se debati siguroi informacione ose perspektiva të reja që i shtynë pjesëmarrësit të rivlerësojnë botëkuptimin e tyre për efektet e sanksioneve. Para debatit, shumica e të anketuarve (68%) ishin kritikë se si Maqedonia e Veriut po trajton efektet ekonomike nga sanksionet. Megjithatë, debati ndikoi në perceptimet, duke çuar në një vlerësim më neutral se si qeveria e trajton situatën më pas (vlerat mesatare 4.32 para debatit dhe 5.20 pas debatit).

Debati nënvizon nevojën për angazhim të vazhdueshëm dhe përpjekje arsimore për të siguruar që publiku është i mirëinformuar dhe i përfshirë në mënyrë aktive në diskutimet kritike që kanë të bëjnë me të ardhmen e shtetit brenda BE-së.

Përfundimisht, ndërgjegjësimi i publikut dhe opinionet mbi çështjet kyçe që janë të ndërlidhura me integrimin në BE dhe përafrimin me PPJS mbeten të miksuara. Pasiguria në mesin e publikut për hapat e nevojshëm për anëtarësimin në BE mund të rrjedhë nga efekti hijezues i çështjeve bilaterale gjatë viteve. Në mënyrë të ngjashme, pasiguria lidhur me sanksionet kundër Rusisë dhe efektet e tyre të brendshme mund të rezultojë nga ekspozimi ndaj informacioneve kontradiktore dhe pohimeve të ekzagjeruar në diskursin publik. Debati kombëtar ofroi një platformë të vlefshme për diskutim, por nuk ndryshoi në mënyrë drastike pikëpamjet veç më të vendosura më herët. Ky rezultat nënvizon nevojën për angazhim të vazhdueshëm dhe përpjekje arsimore për të siguruar që publiku të jetë i mirë informuar dhe i përfshirë në mënyrë aktive në diskutimet kritike që kanë të bëjnë me të ardhmen e shtetit brenda BE-së.

## 2.3 Pikëpamje për anëtarësimin në NATO dhe sigurinë kombëtare


Duke iu bashkangjitur aleancës zyrtarisht në mars 2020, anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut shënoi një moment historik kyç në përku-shtimin e saj për sigurinë kolektive dhe stabi-litetin rajonal. Duke u bërë anëtare e NATO-s, Maqedonia e Veriut është rreshtuar me struk-turat perëndimore të mbrojtjes, duke synuar të forcojë sigurinë e saj dhe të bashkëpunojë më ngushtë me aleatët e saj.

Fillimisht, pati një hutim të konsiderueshëm rreth vitit kur Maqedonia e Veriut u anëtarësua zyrtarisht në NATO, që u shfaq me një pjesë të konsiderueshme të anketuarve me pamundësi identifikimi. Megjithatë, pas debatit, ndërgjeg-jësimi u përmirësua ndjeshëm, 85.9% e iden-tifikuan saktë vitin 2020 si vit të anëtarësimit. Debatit kontribuoi gjithashtu në përmirësimin e njohurive rreth anëtarësimit aktual të NATO-s, me 85.9% të anketuarve duke identifikuar saktë numrin e vendeve anëtare pas debatit, krahasuar me 79.6% më parë. Kjo sugjeron se debati ishte efektiv në rritjen e njohurive të publikut rreth aleancës.

### Në cilin vit Maqedonia e Veriut

u bë zyrtarisht anëtare e plotë e NATO-s?

Pas debatit, përqindja e pjesëmarrësve që identifikuan vitin 2020 si përgjigje të saktë për këtë pyetje u rrit dukshëm, duke arritur në 85.9% krahasuar me 56.7% para debatit, gjë që tregon se ka më shumë qartësi pas debatit.



Kur të anketuarit u pyetën për qëllimin kryesor të NATO-s, shumica fillimisht e njohën mbrojtjen kolektive kundër sulmeve të armatosura si qëllimin kryesor. Pas debatit, kjo njohje u rrit gradualisht në 73.3%, duke shfaqur një kuptim më të qartë të misionit thelbësor të NATO-s. Për më tepër, pati një rritje të lehtë të atyre që e njohën bashkëpunimin ekonomik si synim të NATO-s (nga 6.4% në 7.4%), ndërsa perceptimi se NATO rrit kryesisht ndikimin perëndimor pësoi rënie (nga 17.2% në 9.6%).

Lidhur me efektin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, shumica e të anketuarve ranë dakord se ai forcon sigurinë kombëtare dhe standardet e trajnimit ushtarak. Megjithatë, kishte gjithashtu shqetësime për ndikimin e NATO-s në neutralitetin dhe barrën financiare të vendit. Këto pikëpamje mbetën të pandryshueshme para dhe pas debatit. Debatit poashtu nxjorri në pah rolin e evolucionit të NATO-s në adresimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë. Veçanërisht, pati një rritje të konsiderueshme në numrin e të anketuarve që pranuan rolin e NATO-s në përballjen e kërcënimeve kibernetike dhe adresimin e ndryshimeve klimatike, ku vlerat mesatare u rritën nga 6.88 para debatit në 8.5 pas debatit. Kjo sugjeron

se, derisa pikëpamjet tradicionale mbi rolin e NATO-s mbeten të forta, ka një ndërgjegjësim publik për rritjen e rolit të saj në adresimin e kërcënimeve jo-tradicionale të sigurisë.

Derisa debati ishte efektiv në sqarimin e disa aspekteve, si qëllimi i NATO-s, viti i anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut dhe numri i vendeve anëtare, ai gjithashtu potencoi paqartësitë e vazhdueshme dhe opinionet e ndryshme. Rritja e përgjigjeve të sakta në lidhje me faktet kryesore të NATO-s vë në pah peshën dhe vlerën që kanë diskutimet e informuara. Megjithatë, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të adresuar shqetësimet e mbetura dhe për të ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të rolit dhe përfitimeve të NATO-s.

Nevojiten përpjekje për të adresuar shqetësimet e mbetura dhe për të siguruar një kuptim më gjithëpërfshirës të rolit dhe përfitimeve të NATO-s.

### 3. Konkluzione dhe rekomandime

Stabiliteti i përgjithshëm në opinionet e pjesëmarrësve para dhe pas debatit sugjeron se shumë qytetarë veç se më kanë njohuri për këto tema. Çështjet si integrimi në BE dhe anëtarësimi në NATO janë ngulitur thellë në diskursin publik dhe qytetarët kanë zhvilluar njohuri dhe opinione të qëndrueshme me kalimin e kohës. Një nga rezultatet më të dukshme të anketës debatuuese ishte rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me ndikimin e politikës së jashtme në jetën e përditshme. Përpara debatit, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë nuk e kuptonte plotësisht rëndësinë e vendimeve të politikës së jashtme në përvojat e tyre të përditshme. Megjithatë, pas ngjarjes diskutuese, pjesëmarrësit shfaqën një ndërgjegjësim më të madh se si politika e jashtme, duke përfshirë integrimin në BE dhe anëtarësimin në NATO, ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre. Kjo lëvizje nënvizon potencialin e diskutimeve të informuara për të kapërcyer hendekun midis çështjeve abstrakte të politikave dhe realitetit konkret me të cilat përballen qytetarët. Megjithatë, teksa ekziston një ndërgjegjësim më i madh për ndikimin e vendimeve të politikës së jashtme në jetën e përditshme të qytetarëve, mbetet një boshllëk në kuptimin e proceseve që lidhen me integrimin në BE dhe çfarë përfshin anëtarësimi në NATO. Kjo nënvizon që ka vlerë të jashtëzakonshme angazhimi i qytetarëve në diskutime që thellojnë kuptimin dhe njohuritë e tyre.

Anketa debatuese zbuloi një hezitim të përgjithshëm midis pjesëmarrësve për të përvetësuar plotësisht politikat komplekse të BE-së si Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS). Ndryshimi i kufizuar në njohjen dhe opinionin në lidhje me përafrimin e PPJS-së pasqyron një sfidë më të gjerë në përcjelljen e nuancave të politikave të tilla tek publiku. Pavarësisht ofrimit të materialeve informuese të balancuara dhe diskutimeve të ekspertëve, kompleksiteti i këtyre çështjeve dhe përhapja e informacioneve të tipit mashtrues dhe politizimi me gjitha gjasat kontribuon në ndryshimet e kufizuara të perceptimit publik. Rezultatet gjithashtu shfaqin shqetësimet e vazhdueshme midis qytetarëve në lidhje me kompromiset potenciale lidhur me integrimin në BE dhe anëtarësimin në NATO. Shumë pjesëmarrës shprehën shqetësime rreth humbjes së mundshme të sovranitetit kombëtar pasi një vend bëhet anëtar i BE-së dhe NATO-s, dhe rreth barrës financiare si pasojë e anëtarësim-it të vendit në NATO. Këto shqetësime, megjithëse nuk janë dominuese, tregojnë nevojën për përpjekje më transparente dhe gjithëpërfshirëse të angazhimit publik për të adresuar dyshime dhe rezerva të tilla dhe për të ndër-tuar konsensus më të gjerë rreth objektivave të politikës së jashtme të vendit.

Në përgjithësi, anketa debatuese ofron një tregues të qartë se derisa qytetarët e Maqedonisë së Veriut janë në përgjithësi mbështetës të orientimit euroatlantik të vendit, mbetet nevoja për iniciativa të vazhdueshme arsimore dhe dialog. Duke nxitur një qytetari më të informuar dhe më të angazhuar, dhe duke kundërshtuar në mënyrë aktive dezinformimin, politikëbërësit mund të sigurojnë që politika e jashtme e Maqedonisë së Veriut mbetet njëkohësisht reflektuese dhe e përgjegjshme ndaj pikëpamjeve të popullit të saj, duke rritur kështu legjitimitetin dhe efektivitetin e strategjive ndërkombëtare të vendit.

## Rekomandime:

- Të zhvillohen strategji të komunikimit që shndërrojnë vendimet e politikës së jashtme në efekt praktik në jetën e përditshme të qytetarëve. Të theksohen se si përpjekjet ndërkombëtare, si integrimi në BE dhe anëtarësimi në NATO, ndikojnë në mundësitë ekonomike, sigurinë dhe shërbimet sociale.
- Sigurim që komunikimet e qeverisë për politikën e jashtme janë të qarta, transparente dhe të qasshme.
- Forcimi i partneritetit me organizatat e shoqërisë civile që fokusohen në politikën e jashtme, integrimin në BE dhe çështjet e sigurisë. Këto organizata mund të ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit dhe të jenë në kontakt me komunitetet në të gjithë vendin.
- Organizimi i konsultime publike dhe fushata edukative duke u fokusuar në çështje specifike të politikës së jashtme që ndikojnë drejtpërdrejt te qytetarët. Këto nisma duhet të dizajnohen në mënyrë që të jenë të qasshme dhe relevante për publikun e gjerë.
- Zbatimi i strategjive për të luftuar dezinformimin lidhur me integrimin në BE dhe anëtarësimin e vendit në NATO. Kjo mund të përfshijë shërbime të kontrollit të fakteve dhe ndërgjegjësimin e publikut për të promovuar informacion të saktë.
- Kryerja e anketave të rregullta të opinionit publik për të monitoruar ndryshimet në qëndrimet e qytetarëve ndaj politikës së jashtme. Këto anketa duhet të përdoren për të informuar vendimet e politikave dhe strategjitë e komunikimit.





